


Raport Vjetor për Vlerësimin e Cilësisë

Viti akademik
2020-2021

Njësia e Sigurimit të Cilësisë
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



Lista e shkurtesave

FGJH - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

NJSBC - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

IAL - Institucion i Arsimit të Lartë





Tabela e lëndës

Lista e shkurtesave	2
1. HYRJE	4
2. QËLLIMI	4
3. METODOLOGJIA	5
4. VLERËSIMI I MËSIMDHËNIES NGA STUDENTËT (CIKLI I + II).....	6
4.1 Analiza e gjetjeve të pyetësorit “Formular vlerësimi nga studentët i mësimdhënies në distancë”	6
5. VLERËSIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT “BACHELOR” NGA STUDENTËT QË JANË DIPLOMUAR.....	9
5.1 Përqindjet sipas secilit departament::	10
6. VLERËSIMI NGA PERSONELI AKADEMIK.....	16
6.2 Analiza dhe konkluzionet e pyetësorit:	17
7. REKOMANDIME.....	20
SHTOJCA NR 1	22
SHTOJCA NR. 2	24
SHTOJCA NR. 3	26





1. HYRJE

Ky raport vjen në kuadër të politikave të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja për sigurimin e brendshëm të cilësisë me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë duke u bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, "Sigurimi i brendshëm i cilësisë", si një ndër masat e marra në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, Pika 3 "Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, ajo organizon pyetësonin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi" dhe në aktet nënligjore të tij.

Studentët janë në fokus të Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit dhe si rrjedhim opinioni i tyre mbi programet e studimit dhe lëndët që ata ndjekin janë një burim shumë i rëndësishëm informacioni për rritjen e cilësisë së shërbimeve akademike dhe programeve mësimore që ofron fakulteti. Të dhënat e pasqyruara në këtë raport do të jenë një instrument i rëndësishëm për Njësitë Kryesore/Bazë për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programe mësimore aty ku shihet e nevojshme.

Raporti ka analizuar të dhënat e përfuara nga anketimet e kryera në vitin akademik 2020-2021 për të dy ciklet e studimit, për të gjithë departamentet e FGJH-së të përmbledhura nga katër raportet e veçanta si më poshtë:

1. Raporte përmbledhëse mbi pyetësonin “*Formular vlerësimi nga studentët i mësimdhënies në distancë*” Semestri i parë/i dytë, Viti akademik 2020-2021.
2. Raporti përmbledhës mbi pyetësonin “*Formular vlerësimi i studentëve që janë diplomuar*” për ciklin e parë për periudhën 2018 – 2021.
3. Raport përmbledhës mbi pyetësonin “*Formular vlerësimi nga personeli akademik*”, Viti akademik 2020-2021.

Për çdo njësi bazë paraqitet përqindja e pjesëmarrjes mesatare të studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe programit të studimit, të ndara sipas programeve të studimit, rezultatet e pyetësorëve si dhe rekomandimet dhe sugjerimet përkatëse.

Më poshtë do të pasqyrojmë në mënyrë të detajuar të gjithë hapat e ndjekur për realizimin e procesit të anketimit e deri në gjenerimin e rezultateve dhe hartimin e përfundimeve.

2. QËLLIMI

Qëllimi i këtij pyetësoni:

- a) Vlerësimi i programeve të studimit për studentët që kanë përfunduar studimet.





- ky lloj vlerësimi kryhet në kuadër të nevojave që fakulteti ynë dhe më saktë çdo njësi bazë ka për marrjen e një feedback-u nga ana e studenteve dhe sidomos të atyre që kanë përfunduar ciklet e tyre të studimit, kjo pasi ata tashmë janë të zhveshur nga: ndikimi i ambientit studimor, shoqërisë studentore, pedagogëve dhe varësisë psikologjike si rrjedhojë e të qenit student.

Pse është e nevojshme kjo?

- Vjelja e të dhënave reale nga ky kampion është mjaft i rëndësishëm pasi mundëson evidentimin e pikave të dobëta dhe të forta të programeve tona me qëllim që pas nxjerrjes së rezultateve dhe analizimit e reflektimit të tyre, të merren masat e nevojshme për përmirësimin e pikave të dobëta dhe përforcimin e atyre të forta.
- b) Vlerësimi i mbarëvajtjes mësimore në distancë
 - Vjelja e të dhënave të tilla përben një specifikë më vete, duke qenë përballë një situatë të pazakontë të arsimit të lartë që e vuri atë përballë sfidave të paparashikuara më parë.
 - Vjelja e këtyre të dhëna për herë të parë në arsimin e lartë na përcjell informacione mjaft të rëndësishme lidhur me shumë tipare të këtij lloj mësimi, gjë që është e vlefshme jo vetëm për këtë rast i cili mund të mos përsëritet më, por për një perspektivë të re arsimore të arsimit të lartë (gjë që tashmë në Evropë e në botë ekziston prej shumë vitesh) atij të implementimit të arsimit në distancë për atë kategori studentësh që për shumë arsye nuk mund të vijojnë studimet e tyre. Mosofrimi i kësaj mundësie do të thotë mungesë vizioni dhe mosvlerësim të potencialeve të qenieve njerëzore që nuk kanë mundur t'i shpalosin ato.
- c) Vlerësimi nga ana e personelit akademik
 - Vjelja e këtyre të dhënave është mjaft e rëndësishme pasi shpesh duke vënë në qendër vetëm studentin dashur padashur lëmë në hije një aktor mjaft të rëndësishëm të panoramës didaktike: pedagogun. Kjo figurë mjaft e rëndësishme ka nevojë të pyetet, të përcjellë shqetësimet e tij dhe të dëgjohej me qëllim që kjo figurë jo vetëm të ndjehet e vlerësuar por edhe të ruhet integriteti si jo vetëm si personel akademik por mbi të gjitha si qenie njerëzore.
 - Vjelja e të dhënave konsiston edhe në marrjen e informacioneve lidhur me kërkesat dhe problematikat që ata hasin në të përditshmen dhe sa ato zgjidhjen apo përmbushjen nga njësi bazë dhe ajo kryesore.

3. METODOLOGJIA

Metodologjia e studimit është sasiore dhe cilësore. Pyetësorët e zhvilluar janë hartuar në përputhje me paketën e instrumenteve të cilësisë e miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 51 datë 23.12.2020. Kryerja e vlerësimit studentor për cilësinë e mësimdhënies përcaktohet në





Rregulloren për sigurimin e cilësisë në UT (neni 26, gërma h), dhe zhvillohet në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve.

Procesi mësimor në vitin akademik 2020 – 2021 është zhvilluar tërësisht në distancë. Për rrjedhojë plotësimi i pyetësorëve nga studentët për semestrin e parë dhe të dytë është kryer nëpërmjet aplikacionit Google Forms. Pyetësorët janë të përbërë nga pyetje të mbyllura dhe pyetje të hapura. Të dhënat statistikore për pyetjet e mbyllura janë gjeneruar automatikisht nga aplikacioni, ndërsa përgjigjet pyetjeve të hapura janë përmbledhur nga NJSBC e FJGH-së.

Përgjigjet e hapura të të anketuarve kanë shërbyer njëkohësisht si bazë për dhënien e rekomandimeve përkatëse ose evidentimin e praktikave më të mira. Analiza e hollësishme e rezultateve të pyetësorëve është kryer nga NJSBC në raportet përkatëse, të cilat i janë paraqitur fillimisht drejtuesit të njësisë kryesore, që më pas i ka përcjellë pranë njësive bazë.

4. VLERËSIMI I MËSIMDHËNIES NGA STUDENTËT (CIKLI I + II)


Pyetësori: “*Formular vlerësimi nga studentët i mësimdhënies në distancë*” (Shtojca 1) përbëhet nga 35 pyetje të shtrira në seksionet kryesore:

- I. Përmbajtjen dhe organizimin e lëndës
- II. Pjesëmarrjen e studentin në mësim
- III. Mjedisi i të nxënit dhe metodat e mësimdhënies
- IV. Burimet e të nxënit
- V. Detyrat
- VI. Vlerësimi
- VII. Mbështetja me shërbimin IT

4.1 Analiza e gjetjeve të pyetësorit “Formular vlerësimi nga studentët i mësimdhënies në distancë”.

Nga analiza e gjetjeve të pyetësorit të mësipërm konstatohet se ka një pjesëmarrje prej 514 studentësh nga 2667 studentë, ku 353 i përkasin ciklit Bachelor dhe 156 atij Master.

	Semestri I	Semestri II
Departamenti	Studentë pjesëmarrës/Përqindje	Studentë pjesëmarrës/Përqindje
Gjuhë Angleze	344 / 29.35%	149 / 13.48%
Gjuhë Gjermane	142 / 14.6%	86 / 19.95%





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



Gjuhë Frënge	162 / 16.66%	116 / 32.95%
Gjuhë Italiane	163 / 16.77%	91 / 21.92%
Gjuhë Spanjolle	67 / 7%	25 / 16.77%
Gjuhë Greke	32 / 3.3%	17 / 33.33%
Gjuhë Sllave-Balkanike	59 / 6.1%	28 / 35%

Lidhur me përmbajtjen dhe organizimin e lëndës, nga ky pyetësor, rezulton se 53,69% e studentëve të anketuar i vlerësojnë ato si shumë të qarta dhe të qarta. 16.7% mendojnë se duhej të qartësoheshin më shumë rreth tyre. Lidhur me ngarkesën e lëndëve, 49.02% e studentëve mendojnë se ngarkesa ka qenë e përbalueshme dhe e organizuar mirë, ndërsa 23.73% shënojnë vlerësim më të ulët për këtë komponent.

Në lidhje me pjesëmarrjen e studentëve në mësim, gjejmë se 50.38% e tyre kanë ndjekur orët e mësimit rregullisht dhe 32.1% shënojnë se kanë qenë pjesëmarrës aktiv në mësimin online. Në lidhje me procesin e të nxënies dhe përparimit përmes platformës, ka rezultuar se 18.67% kanë përfitur shumë dhe 12.25% e konsiderojnë të ulët përfitimin. Nga komentet e shprehura në këtë seksion vihet re se studentët shënojnë si problem ato teknike, menaxhimin e kohës së mësimit dhe provimit në platformë, punësimin që krijon përplasje me orarin e mësimit, ngarkesën e madhe me projekte, etj.

Në lidhje me komponentin e strukturimit të lëndëve, nga gjetjet rezulton se 44.93% e studentëve mendojnë se ka një nivel shumë të lartë dhe të lartë të balancimit mes leksioneve, seminareve, etj. Ndërsa 22.95% mendojnë se balancimi nuk është në nivelin e duhur. Komponentët që lidhen me vlerësimin për metodat e mësimdhënies, menaxhimin në mënyrë efektive të mësimit si dhe ndërhyrjet, diskutimet dhe reagimet e papërshtatshme on line të studentëve, përfshirjes së studentëve në të nxënies aktiv duke dhënë detyra në grup, vlerësime për njëri-tjetrin, kërkime në internet, prezantime me multimedia, projekte të bazuara në përvojë, nxitjes së studentëve për të të ndërvepruar me njëri tjetrin dhe me pedagogun duke qenë se ka pasur vlerësime të larta, është tregues i punës së mirë të kryer nga personeli akademik. Afërsisht vlerësimet në shkallën mirë deri shumë mirë janë dhënë nga 46.3% e studentëve. Për të njëjtët komponentë 9-10 % e studentëve shënojnë vlerësim me rezerva. Në lidhje me etikën profesionale gjatë komunikimit online, vërehet se rreth 21.8% e studentëve presin më shumë nga ky komunikim, ndërsa 60.3% janë të kënaqur.

Në lidhje me burimet e të nxënies, tekstet mësimore, leksionet, materialet ndihmëse, literatura e rekomanduar dhe plotësuese, 55% e studentëve i vlerësojnë si shumë të përshtatshme. Ndërsa 18% e tyre mendojnë se jo të gjitha materialet i konsideronin si të mjaftueshme.

Në lidhje me detyrat e ngarkuara dhe të programuara, rreth 50% e studentëve mendojnë se janë të dobishme, ndërsa rreth 19% i vlerësojnë ato si të vështira për t'u realizuar. Nga komentet rezulton se studentët, në përgjithësi, i vlerësojnë detyrat në përvetësimin e lëndës, por një pjesë shprehen se janë të ngarkuara, dhe me pak kohë në dispozicion dhe me vështirësi në rritje sepse iu duhet të punojnë me celular e shpejtësia apo aksesit në internet përbënte problem.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**



Në lidhje me shumëllojshmërinë dhe përshtatshmërinë e metodave të vlerësimit 48.8% e studenteve shënojnë se janë të kënaqur dhe shumë të kënaqur, ndërsa 22.8% shënojnë se nuk janë dakord me këto metoda vlerësimi. Një problem që del në pah dhe që është shumë i ndjeshëm për studentët është dhënia e vlerësimit në kohë ku 22.8% mendojnë se vlerësimet nuk jepen në kohë. Studentët janë shprehur të kënaqur me sqarimet për vlerësimin e tyre, por nga komentet del se ka ende raste kur rezultatet e vlerësimit vonohen, thjesht dërgohen në sekretari pa dhënë asnjë sqarim. Megjithëse ka rregulla të përcaktuara në rregulloret përkatëse të programeve studimore për modalitetet e provimit, dhënies së notës, ankimimit, mënyrës së sqarimit të studentëve, nga të dhënat rezulton se ka pedagogë që nuk i zbatojnë këto rregulla.

Nga komentet e studentëve rezulton se ndër elementet më të forta të mësimdhënies në distancë ishin: mbrojtja e shëndetit, mundësia për ta ndjekur mësimin nga çdo ambient, kosto më të ulëta për ndjekjen e mësimin, komunikimi i menjëhershëm me pedagogët.

Ndërsa ndër problematikat më shqetësuese të mësimdhënies në distancë përmenden: mungesa e komunikimit në klasë, mos krijimi i lidhjeve shoqërore dhe përftimi prej tyre, vështirësi për kuptimin e leksioneve për shkak të pengesave objektive (ndërprerje energjie, interneti dhe mos pasje laptopi.)

Bazuar tek shërbimet mbështetëse të IT së Fakultetit për mundësimin e mësimin online dhe zgjidhjen e problemeve që mund të lindnin, 40% e studentëve shprehen se janë të kënaqur dhe vetëm 10% e tyre janë të pakënaqur. Kjo për faktin se ata i kanë përballuar vetë problemet e tyre. IT e Ut-së dhe Fakultetit ka vepruar në kohë reale, pavarësisht nga orari për të zgjidhur problemet e studentëve me platformën TEAMS.





5. VLERËSIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT "BACHELOR" NGA STUDENTËT QË JANË DIPLOMUAR

Pas gjenerimit automatik të të dhënave (*Shtojca Nr. 2*), rezultoi se nga numri total i studentëve, respektivisht Cikli II: 370, ky pyetësor u plotësua nga 194 studentë, ose 52.4 % e studentëve, të cilët i përkasin vitit të parë të programit Master.

Studentë që plotësuan pyetësorin nga secili departament janë si më poshtë :

- Departamenti i Gjuhës Angleze 98 ose 46 % e studentëve
- Departamenti i Gjuhës Gjermane 18 ose 27 % e studentëve
- Departamenti i Gjuhës Frënge 19 ose 42 % e studentëve
- Departamenti i Gjuhës Italiane 28 ose 60 % e studentëve
- Departamenti i Gjuhës Spanjolle 10 ose 55.5 % e studentëve
- Departamenti i gjuhëve Sllavo – Ballkanike
- Dega e gjuhës turke 4 ose 36.3 % e studentëve
- Departamenti i Gjuhës Greke 2 ose 25 % e studentëve
- Departamenti i gjuhëve Sllavo – Ballkanike
- Dega e gjuhës ruse 5 ose 50 % e studentëve

Saktësojmë se përqindjet e mësipërme janë në përputhje proporcionale edhe me përpjesëtimin e studentëve në bazë departamentesh. Nga 370 studentë të Ciklit të II-të ky pyetësor u plotësua nga 194 studentë, ose 49.7 % e studentëve të cilët i përkasin vitit të parë të programit Master. Nga përqindjet e secilit prej departament vihet re se gati gjysma e studentëve të Departamentit të Anglishtes, Departamentit të Gjuhës Frënge dhe Departamenti i Gjuhëve Sllavo Ballkanike (dega e gjuhës ruse), kanë marrë pjesë në plotësimin e pyetësorit. Vlerësohet se Gjuha Italiane dhe Spanjolle kanë pjesëmarrjen më të lartë në plotësimin e pyetësorit, me më shumë se 50%. Një pjesëmarrje më e ulët, rreth 30% vërehet në Departamentet e Gjuhës Gjermane dhe Departamenti i Gjuhëve Sllavo Ballkanike (dega e gjuhës turke), e pak më pak në Departamentin e Gjuhës Greke.






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



5.1 Përqindjet sipas secilit departament:

Pyetjet	Departamenti i Gjuhës Gjermane				
	Shumë i kenaqur	I kënaqur	Nuk ka dijeni	I pakënaqur	Shumë i pakënaqur
Programi përmban informacion të detajuar.	33.33%	55.56%	5.56%	0.00%	0.00%
Programi nxit aftësitë për të punuar në grup.	16.67%	50.00%	22.22%	11.11%	0.00%
Administrimi i programit është i efektshëm dhe mbështet procesin e të nxënit.	27.78%	55.56%	11.11%	5.56%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive analitike dhe ato që kanë të bëjnë më zgjidhjen e problemeve.	22.22%	55.56%	16.67%	5.56%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e të menduarit të pavarur.	33.33%	61.11%	0.00%	5.56%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive të komunikimit me shkrim	22.22%	66.67%	0.00%	11.11%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive të planifikimit.	27.78%	50.00%	16.67%	5.56%	0.00%
Objektivat e programit janë arritur plotësisht	16.67%	55.56%	22.22%	5.56%	0.00%
Përmbajtja e kurrikulës është e avancuar dhe i përmbush objektivat e programit	22.22%	66.67%	5.56%	5.56%	0.00%
Pedagogët përmbushin objektivat e programit.	33.33%	66.67%	0.00%	0.00%	0.00%
Mjedisi mbështet procesin e të nxënit.	27.78%	33.33%	5.56%	22.22%	5.56%
Infrastruktura e departamentit përmbush kërkesat e programit	22.22%	55.56%	11.11%	0.00%	5.56%
Programi shoqërohej me aktivitete ekstra-kurrikulës	16.67%	33.33%	27.78%	16.67%	5.56%
Studentët në vështirësi merrnin bursë	38.89%	22.22%	33.33%	0.00%	0.00%

Pyetjet	Departamenti i Gjuhës Frënge				
	Shumë i kënaqur	I kënaqur	Nuk ka dijeni	I pakënaqur	Shumë i pakënaqur
Programi përmban informacion të detajuar.	42.11%	36.84%	5.26%	5.26%	0.00%
Programi nxit aftësitë për të punuar në grup.	21.05%	47.37%	10.53%	21.05%	0.00%
Administrimi i programit është i efektshëm dhe mbështet procesin e të nxënit.	21.05%	57.89%	5.26%	15.79%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive analitike dhe ato që kanë të bëjnë më zgjidhjen e problemeve.	36.84%	36.84%	26.32%	0.00%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e të menduarit të pavarur.	42.11%	31.58%	15.79%	10.53%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive të komunikimit me shkrim	42.11%	42.11%	5.26%	10.53%	0.00%





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



Programi nxit zhvillimin e aftësive të planifikimit.	21.05%	36.84%	31.58%	10.53%	0.00%
Objektivat e programit janë arritur plotësisht	15.79%	47.37%	26.32%	10.53%	0.00%
Përmbajtja e kurrikulës është e avancuar dhe i përmbush objektivat e programit	36.84%	42.11%	15.79%	5.26%	0.00%
Pedagogët përmbushin objektivat e programit.	31.58%	42.11%	5.26%	15.79%	0.00%
Mjedisi mbështet procesin e të nxënit.	10.53%	47.37%	15.79%	26.32%	0.00%
Infrastruktura e departamentit përmbush kërkesat e programit	21.05%	36.84%	10.53%	21.05%	10.53%
Programi shoqërohej me aktivitete ekstra-kurrikulës	5.26%	26.32%	21.05%	36.84%	10.53%
Studentët në vështirësi merrnin bursë	21.05%	42.11%	26.32%	5.26%	5.26%

Pyetjet	Departamenti i Gjuhës Angleze				
	Shumë i kënaqur	I kënaqur	Nuk ka dijeni	I pakënaqur	Shumë i pakënaqur
Programi përmban informacion të detajuar.	34.69%	59.18%	1.02%	5.10%	0.00%
Programi nxit aftësitë për të punuar në grup.	31.63%	43.88%	9.18%	12.24%	2.04%
Administrimi i programit është i efektshëm dhe mbështet procesin e të nxënit.	27.55%	56.12%	11.22%	3.06%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive analitike dhe ato që kanë të bëjnë më zgjidhjen e problemeve.	20.41%	43.88%	13.27%	16.33%	2.04%
Programi nxit zhvillimin e të menduarit të pavarur.	41.84%	41.84%	6.12%	10.20%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive të komunikimit me shkrim	38.78%	55.10%	2.04%	4.08%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive të planifikimit.	19.39%	41.84%	24.49%	10.20%	2.04%
Objektivat e programit janë arritur plotësisht	10.20%	36.73%	33.67%	16.33%	2.04%
Përmbajtja e kurrikulës është e avancuar dhe i përmbush objektivat e programit	27.55%	48.98%	14.29%	7.14%	0.00%
Pedagogët përmbushin objektivat e programit.	35.71%	50.00%	9.18%	4.08%	0.00%
Mjedisi mbështet procesin e të nxënit.	11.22%	39.80%	12.24%	30.61%	5.10%
Infrastruktura e departamentit përmbush kërkesat e programit	11.22%	35.71%	19.39%	27.55%	6.12%
Programi shoqërohej me aktivitete ekstra-kurrikulës	7.14%	28.57%	19.39%	29.59%	13.27%
Studentët në vështirësi merrnin bursë	40.82%	29.59%	24.49%	2.04%	3.06%





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



Pyetjet	Departamenti i Gjuhës Italiane				
	Shumë i kënaqur	I kënaqur	Nuk ka dijeni	I pakënaqur	Shumë i pakënaqur
Programi përmban informacion të detajuar.	50.00%	46.43%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi nxit aftësitë për të punuar në grup.	35.71%	53.57%	10.71%	0.00%	0.00%
Administrimi i programit është i efektshëm dhe mbështet procesin e të nxënit.	46.43%	50.00%	3.57%	0.00%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive analitike dhe ato që kanë të bëjnë më zgjidhjen e problemeve.	39.29%	50.00%	7.14%	3.57%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e të menduarit të pavarur.	67.86%	21.43%	7.14%	0.00%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive të komunikimit me shkrim	50.00%	35.71%	3.57%	3.57%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive të planifikimit.	28.57%	50.00%	10.71%	10.71%	0.00%
Objektivat e programit janë arritur plotësisht	28.57%	46.43%	10.71%	14.29%	0.00%
Përmbajtja e kurrikulës është e avancuar dhe i përmbush objektivat e programit	50.00%	39.29%	7.14%	0.00%	0.00%
Pedagogët përmbushin objektivat e programit.	60.71%	28.57%	0.00%	7.14%	0.00%
Mjedisi mbështet procesin e të nxënit.	25.00%	53.57%	7.14%	7.14%	3.57%
Infrastruktura e departamentit përmbush kërkesat e programit	35.71%	35.71%	7.14%	14.29%	3.57%
Programi shoqërohej me aktivitete ekstra-kurrikulës	17.86%	17.86%	39.29%	21.43%	3.57%
Studentët në vështirësi merrnin bursë	35.71%	25.00%	21.43%	10.71%	3.57%

Pyetjet	Departamenti i Gjuhës Spanjolle				
	Shumë i kënaqur	I kënaqur	Nuk ka dijeni	I pakënaqur	Shumë i pakënaqur
Programi përmban informacion të detajuar.	71.43%	28.57%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi nxit aftësitë për të punuar në grup.	57.14%	42.86%	0.00%	0.00%	0.00%
Administrimi i programit është i efektshëm dhe mbështet procesin e të nxënit.	57.14%	42.86%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive analitike dhe ato që kanë të bëjnë më zgjidhjen e problemeve.	71.43%	14.29%	14.29%	0.00%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e të menduarit të pavarur.	71.43%	14.29%	14.29%	0.00%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive të komunikimit me shkrim	57.14%	42.86%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive të planifikimit.	42.86%	28.57%	28.57%	0.00%	0.00%
Objektivat e programit janë arritur plotësisht	28.57%	57.14%	14.29%	0.00%	0.00%





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



Përmbajtja e kurrikulës është e avancuar dhe i përmbush objektivat e programit	14.29%	85.71%	0.00%	0.00%	0.00%
Pedagogët përmbushin objektivat e programit.	85.71%	14.29%	0.00%	0.00%	0.00%
Mjedisi mbështet procesin e të nxënit.	28.57%	57.14%	14.29%	0.00%	0.00%
Infrastruktura e departamentit përmbush kërkesat e programit	42.86%	57.14%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi shoqërohej me aktivitete ekstra-kurrikulës	14.29%	57.14%	14.29%	0.00%	0.00%
Studentët në vështirësi merrnin bursë	14.29%	28.57%	28.57%	14.29%	0.00%

Pyetjet	Departamenti i Gjuhës Greke				
	Shumë i kënaqur	I kënaqur	Nuk ka dijeni	I pakënaqur	Shumë i pakënaqur
Programi përmban informacion të detajuar.	50.00%	50.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi nxit aftësitë për të punuar në grup.	0.00%	100.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Administrimi i programit është i efektshëm dhe mbështet procesin e të nxënit.	50.00%	50.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive analitike dhe ato që kanë të bëjnë më zgjidhjen e problemeve.	0.00%	100.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e të menduarit të pavarur.	50.00%	50.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive të komunikimit me shkrim	50.00%	50.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive të planifikimit.	50.00%	50.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Objektivat e programit janë arritur plotësisht	100.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Përmbajtja e kurrikulës është e avancuar dhe i përmbush objektivat e programit	50.00%	50.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Pedagogët përmbushin objektivat e programit.	100.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Mjedisi mbështet procesin e të nxënit.	100.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Infrastruktura e departamentit përmbush kërkesat e programit	50.00%	50.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi shoqërohej me aktivitete ekstra-kurrikulës	100.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Studentët në vështirësi merrnin bursë	0.00%	0.00%	100.00%	0.00%	0.00%





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



Pyetjet	Departamenti i Gjuhëve Sllavo – Ballkanike – Gjuha Turke				
	Shumë i kënaqur	I kënaqur	Nuk ka dijeni	I pakënaqur	Shumë i pakënaqur
Programi përmban informacion të detajuar.	100.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi nxit aftësitë për të punuar në grup.	71.43%	28.57%	0.00%	0.00%	0.00%
Administrimi i programit është i efektshëm dhe mbështet procesin e të nxënit.	57.14%	42.86%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive analitike dhe ato që kanë të bëjnë më zgjidhjen e problemeve.	57.14%	42.86%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e të menduarit të pavarur.	71.43%	28.57%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive të komunikimit me shkrim	57.14%	42.86%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive të planifikimit.	71.43%	28.57%	0.00%	0.00%	0.00%
Objektivat e programit janë arritur plotësisht	42.86%	14.29%	42.86%	0.00%	0.00%
Përmbajtja e kurrikulës është e avancuar dhe i përmbush objektivat e programit	85.71%	14.29%	0.00%	0.00%	0.00%
Pedagogët përmbushin objektivat e programit.	71.43%	28.57%	0.00%	0.00%	0.00%
Mjedisi mbështet procesin e të nxënit.	71.43%	28.57%	0.00%	0.00%	0.00%
Infrastruktura e departamentit përmbush kërkesat e programit	42.86%	57.14%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi shoqërohet me aktivitete ekstra-kurrikulës	28.57%	42.86%	14.29%	0.00%	0.00%
Studentët në vështirësi mermin bursë	57.14%	14.29%	28.57%	0.00%	0.00%

Pyetjet	Departamenti i Gjuhëve Sllavo – Ballkanike – Gjuha Ruse				
	Shumë i kënaqur	I kënaqur	Nuk ka dijeni	I pakënaqur	Shumë i pakënaqur
Programi përmban informacion të detajuar.	100.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi nxit aftësitë për të punuar në grup.	60.00%	40.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Administrimi i programit është i efektshëm dhe mbështet procesin e të nxënit.	60.00%	40.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive analitike dhe ato që kanë të bëjnë më zgjidhjen e problemeve.	60.00%	40.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e të menduarit të pavarur.	80.00%	20.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive të komunikimit me shkrim	60.00%	40.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Programi nxit zhvillimin e aftësive të planifikimit.	60.00%	40.00%	0.00%	0.00%	0.00%





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



Objektivat e programit janë arritur plotësisht	20.00%	40.00%	40.00%	0.00%	0.00%
Përmbajtja e kurrikulës është e avancuar dhe i përmbush objektivat e programit	60.00%	20.00%	0.00%	20.00%	0.00%
Pedagogët përmbushin objektivat e programit.	80.00%	20.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Mjedisi mbështet procesin e të nxënit.	20.00%	60.00%	20.00%	0.00%	0.00%
Infrastruktura e departamentit përmbush kërkesat e programit	40.00%	0.00%	20.00%	40.00%	0.00%
Programi shoqërohej me aktivitete ekstra-kurrikulës	100.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Studentët në vështirësi merrnin bursë	80.00%	20.00%	0.00%	0.00%	0.00%





6. VLERËSIMI NGA PERSONELI AKADEMIK

Pyetësori “Formular i vlerësimit nga personeli akademik” (Shtojca Nr. 3) përbëhet nga 20 seksione :

1. Departamenti (ku tregohet numri i personelit akademik që ka plotësuar pyetësorin)
2. Kombinimi i kërkimit, mësimdhënies dhe shërbimit në komunitet.
3. Stimulimi intelektual në punë
4. Lloji i mësimdhënies/kërkimit që bëni aktualisht
5. Ndërveprimi me studentët
6. Bashkëpunimi me kolegët
7. Këshillimi që keni në dispozicion
8. Mbështetja administrative që merrni nga departamenti
9. Qartësia në lidhje me procesin e promovimit të personelit akademik
10. Perspektivat tuaja për avancim dhe progres në karrierë
11. Paga
12. Siguria dhe qëndrueshmëria e punës në departament
13. Sasia e kohës që keni në dispozicion për veten dhe familjen tuaj
14. Atmosfera e përgjithshme në departament
15. Sa i përdor departamenti përvojën dhe njohuritë tuaja
16. Cilët janë aktualisht faktorët kryesorë që ju motivojnë dhe ju falin kënaqësi në punë
17. Përmendi disa faktorë që mund të përmirësojnë motivimin tuaj në punë
18. Të dhëna si anëtar fakulteti (titulli akademik)
19. Të dhëna si anëtar fakulteti (grada shkencore)
20. Të dhëna si anëtar fakulteti (vitet e punës)

Personeli Akademik që plotësoi pyetësorin nga secili departament është si më poshtë:

- | | |
|--|-------------------------------------|
| - Departamenti i Gjuhës Angleze | 26 ose 55,3 % e personelit akademik |
| - Departamenti i Gjuhës Gjermane | 11 ose 68,75% e personelit akademik |
| - Departamenti i Gjuhës Frënge | 14 ose 70% e personelit akademik |
| - Departamenti i Gjuhës Italiane | 12 ose 57,1% e personelit akademik |
| - Departamenti i Gjuhës Spanjolle | 2 ose 25% e personelit akademik |
| - Departamenti i Gjuhës Greke | 3 ose 42,8% e personelit akademik |
| - Departamenti i Gjuhëve Sllave-Ballkanike | 5 ose 50% e personelit akademik |

Saktësojmë se përqindjet e mësipërme janë në përputhje proporcionale me përpjesëtimin e personelit akademik për departamentin përkatës.





6.1 Gjetjet me përqindje sipas pyetjeve

Pyetje	Shumë i kënaqur	I kënaqur	Nuk ka dijeni	I pakënaqur	Shumë i pakënaqur
Kombinimi i kërkimit, mësimdhënies dhe shërbimit në komunitet	19,2%	42,4%	27,4%	9,6%	1,4%
Stimulimi intelektual në punë	17,8 %	52 %	9,6 %	17.8 %	2,7 %
Lloji i mësimdhënies/kërkimit që bëni aktualisht	35,6 %	43,3 %	9,2 %	6,8 %	0 %
Ndërveprimi me studentët	49,3 %	39,7 %	8,2 %	2,7 %	0 %
Bashkëpunimi me kolegët	42,5 %	41 %	4,1 %	10.95 %	1,4 %
Këshillimi që keni në dispozicion	16.7 %	46,6 %	21,9 %	11 %	4,1 %
Mbështetja administrative që merrni nga departamenti	47,9 %	39,7 %	5,5 %	5,5 %	1,4 %
Qartësia në lidhje me procesin e promovimit të personelit akademik	28.8 %	39.7 %	16,4 %	9,6 %	5,5 %
Perspektivat tuaja për avancim dhe progres në karrierë	26 %	41 %	17,8 %	9,6 %	5,5 %
Paga	4,2 %	9,2 %	11 %	38.4 %	27,4 %
Siguria dhe qëndrueshmëria e punës në departament	28,8 %	53,4 %	12,3 %	1,4 %	4,1 %
Sasia e kohës që keni në dispozicion për veten dhe familjen tuaj	4,1 %	49,3 %	15 %	20,5 %	9,6 %
Atmosfera e përgjithshme në departament	23,3 %	52 %	8,2 %	9,6 %	6,8 %
Sa i përdor departamenti përvojën dhe njohuritë tuaja	24,7 %	42,5 %	17,8 %	6,8 %	8.2 %

6.2 Analiza dhe konkluzionet e pyetësorit:

Ka një pjesëmarrje prej 56,56 % në plotësimin e këtij pyetësori gjë që tregon një interes mesatar të personelit akademik në përmbushjen e një detyrim institucional, por kryesorja në shprehjen e mendimit dhe opinionin personal në lidhje me një tërësi çështjesh që lidhen ngushtë me profesionin, karrierën etj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



Rezultoni që 46,6% është i kënaqur me këtë kombinim, por ajo që vihet re është se 27,4 % e tyre nuk është në dijeni të tij, gjë që tregon nevojën e informimit mbi këtë aspekt.

Në lidhje me këtë pyetje rezultoni që 53% e personelit është e kënaqur, por përveç faktit që 9,6% rezultoni në padijeni të këtij aspekti ajo që shqetëson është fakti që 17,8% i tyre rezultoni të jetë i pakënaqur

Në lidhje me pyetjen rezultoni që 43,3% është i kënaqur me llojin e mësimdhënies dhe kërkimit. I paqartë fakti pse 8,2% rezultoni në padijeni të tij, gjë që përbën një fakt shqetësues pasi tregon për një personel akademik të mbetur në mëdysheje në lidhje me këtë aspekt.

Ndërveprimi me studentët rezultoni në 49.3 % shumë i kënaqshëm dhe në 2,7 % i pakënaqshëm.

Në lidhje me bashkëpunimin me kolegët ajo që shqetëson është fakti që 10,95% e tyre rezultoni e pakënaqur dhe 1,4 shumë e pakënaqur.

Në lidhje me këshillimin fakti shqetësues është që 11% e tyre është e pakënaqur dhe 4,1 % është shumë e pakënaqur.

Mbështetja administrative në rang departamenti rezultoni shumë e kënaqshme për 47,9% të personelit por ajo që vihet re është që 5, 5% nuk është në dijeni dhe 5,5% e personelit është e pakënaqur me llojin e mbështetjes që i ofrohet.

Në lidhje me këtë pyetje rezultoni që në progresin në karrierë 9,6 % e personelit është e pakënaqur. Fakti që kjo përqindje personelit rezultoni e pakënaqur në lidhje me progresin në karrierë do të thotë që ata nuk e gjejnë vetën të projektuar në të ardhmen progresuese në këtë profesion apo vend pune, gjë që për një IAL duhet të jetë fakt shqetësues.

Lidhur me pagën në vendin e punës rezultoni se pjesa më e madhe e personelit akademik, 65,8 % janë (shumë) të pakënaqur, por ajo që vihet re gjithashtu është se 11% e personelit nuk është në dijeni dhe 4.2% janë shumë të kënaqur.

Siguria dhe qëndrueshmëria e punës në departament rezultoni e kënaqshme për 53,4 % e personelit akademik dhe shumë e kënaqshme për 28.8%. Theksojmë se 4.1% e tyre janë shumë të pakënaqur me këtë pikë.

Sasia e kohës që personeli akademik ka në dispozicion për veten dhe familjen rezultoni në 49,3 % i kënaqshëm, në 20,5 % i pakënaqshëm dhe në 9.6 % shumë i pakënaqshëm.

Në lidhje me pyetjen rezultoni se 52 % e personelit akademik është i kënaqur me atmosferën e përgjithshme në departament, ndërkohë që 6.8 % janë shumë të pakënaqur. Këtu vihet re gjithashtu se 8.2 % nuk kanë dijeni lidhur me këtë pikë.

Rezultoni se 42.5 % e personelit akademik është i kënaqur me këtë pikë dhe 8.2 % shumë të pakënaqur. Vlen për tu theksuar se lidhur me përdorimin nga ana e departamentit të përvojës njohurive të personelit akademik, 17, 8 % e tyre janë shprehur se nuk kanë dijeni.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**



Në lidhje me faktorët kryesor që ndikojnë në motivimin dhe kënaqësinë në punë rezultojnë se mendimet janë të ndryshme dhe fokusi vihet kryesisht tek bashkëpunimi dhe fryma në grup, mësimdhënia dhe ndërveprimi me studentët, si dhe tek mundësitë më të mira për kërkimin shkencor.

Faktorë përmirësues të motivimit në punë nga personeli akademik shihen paga e lartë, transparenca, klima pozitive dhe bashkëpunimi mes kolegëve. Ngarkesa, dhe orët mësimore, si dhe infrastruktura institucionale dhe mësimore, apo dhe trajnimet në universitetet evropiane shihen gjithashtu si faktor për t'u përmirësuar.

Rezultoi se numri i pedagogëve me titullin akademik "Profesor" ishte 12.3 % dhe "Profesor i Asociuar" ishte 11 %. Ndërsa 39.7 % janë "docent" dhe 31,5 % kanë përzgjedhur alternativën "tjetër".

Rezultoi se numri i pedagogëve me gradën shkencore "doktor" ishte 78 %.

Rezultoi se 37 % e personelit akademik kanë më shumë se 20 vite përvojë pune dhe vetëm 1,4 % ka 1 deri në 5 vite punë në fakultet.





7. REKOMANDIME

7.1 Në lidhje me pjesëmarrjen në anketime, rekomandohet:

Ndërgjegjësim dhe nxitje e vazhdueshme e personelit akademik dhe e studentëve për të marrë pjesë në pyetësorë të kësaj natyre, në mënyrë që vlerësimi të jetë sa më real dhe të dhënat që vijnë nga analizimi i pyetësorëve sa më gjithëpërfshirëse.

Analizimi i shkaqeve të pjesëmarrjes së ulët të të anketuarve nga çdo departament, hartimi i strategjive dhe marrja e masave të nevojshme për pjesëmarrje më të gjerë në lidhje me pyetësorët që do të zhvillohen në vijim.

7.2 Në lidhje me cilësinë e programeve të ofruara në FGJH, rekomandohet:

Informimi i vazhdueshëm dhe cilësor i studentëve për programet që ofrohen me të gjitha mjetet e informimit në zotërim.

Analiza e arsyeve të *mosdijenisë* dhe të *pakënaqësive* të studentëve lidhur me një program të caktuar, marrja e mendimit të studentëve në lidhje me përmirësimin e programeve, me qëllim ofrimin e programeve të studimit të tilla ku numri i studentëve të pakënaqur të reduktohet maksimalisht.

Bashkëpunim më i ngushtë me studentët me qëllim vjeljen e informacioneve të nevojshme që ndihmojnë në shqyrtimin real të nevojave të tyre mbi bazën e të cilave të mundësohet përmirësimi i programeve studimore ekzistues.

Përdorim më i gjerë i punës në grup duke u dhënë mundësinë të gjithëve të jenë pjesëmarrës dhe të njohin dinamikat që ka puna në grup dhe si realizohet ajo, në mënyrë të tillë që kjo të kthehet edhe në një metodologji të së ardhmes në përballjen me botën e punës.

Analiza e kujdesshme e tregut të punës me qëllim përshtatjen e programeve sipas kërkesave të këtij tregu.

Rishikimi i programeve me qëllim përshtatjen e tyre me kërkesat e kohës duke i pasuruar vazhdimisht me njohuri dhe metodologji bashkëkohore.

Integrim më dinamik i mjeteve teknologjike për qëllime mësimore dhe kërkimore.

Shtimi i veprimtarive mësimore dhe/ose ekstrakurrikulare që nxisin të menduarin kritik dhe analitik te studentët, si dhe liri të shprehuri mendimi, diskutimi, debati konstruktiv.

Bashkëpunim i ngushtë dhe përcaktim i një plani pune me Zyrën e Zhvillimit të Karrierës për të ndihmuar çdo student në zhvillimin e karrierës studimore dhe profesionale.





7.3 Në lidhje me cilësinë e performancës së personelit akademik, rekomandohet:

Motivim i vazhdueshëm i personelit akademik për të zhvilluar në mënyrë cilësore veprimtarinë akademike e profesionale.

Promovim i vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës i përvojës dhe i arritjeve të personelit akademik. Në këtë mënyrë arrihet dhe rritja e cilësisë së individit, por edhe e njësisë bazë dhe asaj kryesore.

Të ofrohen forma mbështetëse këshilluese, të cilat ndihmojnë personelin akademik në zgjidhjen e problematikave të ndryshme, në kërkimin shkencor, dhe në rritjen në karrierë.

Duke iu referuar gjenerimit të të dhënave, të bëhen përpjekje për rritjen e pagës së personelit akademik si një aspekt mjaft i rëndësishëm dhe nxitës për zhvillimin e mëtejshëm të karrierës akademike.

7.4 Në lidhje me infrastrukturën, rekomandohet:

Çdo departament së bashku me strukturat e tjera të fakultetit të bashkërendojnë punën për përmirësimin e aspekteve që janë të lidhura me infrastrukturën, teknologjinë, ambientet etj.





SHTOJCA NR 1

Formular vlerësimi nga studentët i mësimdhënies në distancë

Semestri i parë/i dytë

Viti akademik 2020-2021

Departamenti _____

Ju lutemi jepni mendimin tuaj të sinqertë dhe konstruktiv në mënyrë që të përmirësohet cilësia e mësimdhënies në distancë.

Për të plotësuar këtë formular përdorni shkallën nga 1 deri 5, ku 1 tregon shkallën më të ulët, ndërsa 5 më të lartë. Shënoni X në kutinë e shkallës vlerësuese që përkon me vlerësimin tuaj për çdo deklaratë.

Ky formular mbetet konfidencial.

Përmbajtja dhe organizimi i lëndës	1	2	3	4	5	Nuk e di
1. Objektivat e lëndëve ishin të qarta.						
2. Ngarkesa e lëndëve ishte e përballueshme.						
3. Lënda ishte e organizuar mirë (marrja në kohë e materialeve, njoftimet për ndryshime).						
Kontributi i studentit						
4. Sa % të orëve të lëndëve keni frekuentuar mesatarisht?						
5. Unë jam aktivizuar gjatë lëndës.						
6. Mendoj se kam përfituar dhe përparuar nga mësimi <i>on line</i> .						
7. Komente						
Mjedisi i të nxënit dhe metodat e mësimdhënies						
8. Mendoj se lëndët ishin strukturuar mirë për të arritur rezultatet e të nxënit (balancim i mirë ndërmjet leksioneve, seminareve, detyrave dhe konsultimeve etj.).						
9. Metodat e të nxënit dhe të mësimdhënies nxisnin pjesëmarrjen.						
10. Pedagogoet u përgjigjen e-maileve të studentëve brenda një afati të shkurtër.						
11. Menaxhohen në mënyrë efektive ndërhyrjet, diskutimet dhe reagimet e papërshtatshme <i>on line</i> të studentëve.						
12. Mundësohet përfshirja e studentëve në të nxënit aktiv duke dhënë detyra në grup, vlerësime për njëri-tjetrin, kërkime në internet, prezantime me multimedia, projekte të bazuara në përvojë.						
13. Manifestohet etikë profesionale në komunikimin virtual						
14. Nxiten studentet të ndërveprojnë me njeri tjetrin dhe me pedagogun.						
15. Lëndët kishin një ngarkesë të përshtatshme.						
16. Komente						
Burimet e të nxënit						





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



17. Materialet mësimore (teksti, leksionet, materialet ndihmëse për lëndën etj.) ishin të përshtatshme dhe të dobishme.									
18. Librat e rekomanduar ishin të rëndësishëm dhe të përshtatshëm									
19. Ofrimi i burimeve të të nxënit në Internet ishte i mjaftueshëm.									
20. Komente									
Detyrat									
21. Detyrat ishin të dobishme.									
22. Isha i/e kënaqur me sasinë e punës së pavarur që kërkohej për kryerjen e detyrave.									
23. Udhëzimet për kryerjen e detyrave ishin të qarta.									
24. Komente									
Vlerësimi									
25. Metodatat e vlerësimit ishin të ndryshme dhe të përshtatshme.									
26. Rezultatet e vlerësimit jepen në kohë.									
27. Komentet e marra për vlerësimin ishin të dobishme.									
28. Komente									
29. Cili është vlerësimi i përgjithshëm për mësimdhënien e lëndëve në distancë?									
30. Elementi më i fortë i mësimdhënies në distancë ishte: Komente									
31. Elementi më i dobët i mësimdhënies në distancë ishte: Komente									
32. Ndryshimi më i rëndësishëm që duhet bërë në mësimdhënien e lëndëve në distancë është: Komente									
33. Shërbimi i IT dhe funksionimi i platformës Microsoft teams									
34. Zyra IT e fakultetit tuaj u përgjigjet problematikave tuaja të regjistrimit në platformë.									

JU FALEMINDERIT





SHTOJCA NR. 2

**Vlerësim i studentëve që diplomohen
(Të plotësohet nga studentët para se të marrin diplomën)**

Vlerësimi kërkon të marrë të dhëna nga studentët që diplomohen në lidhje me cilësinë e arsimimit që kanë marrë në programin që kanë ndjekur si dhe me nivelin e përgatitjes që morën në UT. Qëllimi i këtij vlerësimi është që të gjykojë cilësinë e programeve të studimit. Ne kërkojmë ndihmën tuaj në plotësimin e këtij formulari.

Departmenti _____ Viti akademik _____

Cikli i studimeve: Bachelor _____; MSH _____; MP _____

Shkallët e vlerësimit

A: Shumë i kënaqur B: I kënaqur C: Nuk e di D: I pakënaqur E: Shumë pakënaqur

- Programi përmban informacion të detajuar.
A B C D E
- Programi nxit aftësitë për të punuar në grup.
A B C D E
- Administrimi i programit është i efektshëm dhe mbështet procesin e të nxënësit.
A B C D E
- Programi nxit zhvillimin e aftësive analitike dhe ato që kanë të bëjnë me zgjidhjen e problemeve.
A B C D E
- Programi nxit zhvillimin e të menduarit të pavarur.
A B C D E
- Programi nxit zhvillimin e aftësive të komunikimit me shkrim.
A B C D E
- Programi nxit zhvillimin e aftësive të planifikimit.
A B C D E





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



8. Objektivat e programit janë arritur plotësisht.
- A B C D E
9. Përmbajtja e kurrikulës është e avancuar dhe i përmbush objektivat e programit.
- A B C D E
10. Pedagogët përmbushin objektivat e programit.
- A B C D E
11. Mjedisi mbështet procesin e të nxënit.
- A B C D E
12. Infrastruktura e departamentit përmbush kërkesat e programit
- A B C D E
13. Programi shoqërohej me aktivitete ekstra-kurrikulare.
- A B C D E
14. Studentët në vështirësi merrnin bursë.
- A B C D E
15. Praktika ndihmon në përmirësimin e:
- a. Aftësisë për të punuar në grup (A) (B) (C) (D) (E)
- b. Të menduarit e pavarur (A) (B) (C) (D) (E)
- c. Vlerësimin të vlerave etike (A) (B) (C) (D) (E)
- d. Zhvillimit profesional (A) (B) (C) (D) (E)
- e. Aftësive të menaxhimit të kohës (A) (B) (C) (D) (E)
- f. Gjykimin (A) (B) (C) (D) (E)
- g. Disiplinës (A) (B) (C) (D) (E)
- h. Lidhjes së teorisë me praktikës (A) (B) (C) (D) (E)
16. Cilat janë aspektet pozitive të programit që ndoqët?
17. Cilat aspekte të programit tuaj mund të përmirësohen?





SHTOJCA NR. 3

Formular i vlerësimit nga personeli akademik

(Të plotësohet në fund të çdo viti akademik nga çdo pedagog i fakultetit)

Qëllimi i këtij instrumenti është të vlerësojë nivelin e kënaqësisë së personeli akademik për të ndihmuar në përmirësimin e tyre profesional. Ne kërkojmë ndihmën tuaj për plotësimin e këtij pyetëtori dhe informacioni i dhënë do të mbetet konfidencial.

Tregoni sesa të kënaqur jeni me secilin prej aspekteve të mëposhtme të veprimtarisë në departamentin tuaj?

A: Shumë i kënaqur B: I kënaqur C: Nuk e di D: I pakënaqur E: Shumë i pakënaqur

- Kombinimi i kërkimit, mësimdhënies dhe shërbimit në komunitet.
A B C D E
- Stimulimi intelektual në punë.
A B C D E
- Lloji i mësimdhënies/kërkimit që bëni aktualisht.
A B C D E
- Ndërveprimi me studentët.
A B C D E
- Bashkëpunimi me kolegët.
A B C D E
- Këshillimi që keni në dispozicion.
A B C D E
- Mbështetja administrative që merrni nga departamenti.
A B C D E
- Qartësia në lidhje me procesin e promovimit të personelit akademik.
A B C D E
- Perspektivat tuaja për avancimin dhe progres në karrierë.
A B C D E
- Paga.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



A B C D E

11. Siguria dhe qëndrueshmëria e punës në departament.

A B C D E

12. Sasia e kohës që keni në dispozicion për veten dhe familjen tuaj.

A B C D E

13. Atmosfera e përgjithshme në departament.

A B C D E

14. Sa i përdor departamenti përvojën dhe njohuritë tuaja.

A B C D E

15. Cilët janë aktualisht faktorët kryesorë që ju motivojnë dhe ju falin kënaqësi në punë:

16. Përmendi disa faktorë që mund të përmirësojnë motivimin tuaj në punë.

Të dhëna si anëtar i fakultetit

i. Titulli akademik: A: Profesor B: Profesor i Asociuar C: Docent D: Tjetër

ii. Grada shkencore:

A: Doktor B: Tjetër _____

Vitet e punës:

A: 1-5 B: 6-10 C: 11-15 D: 16-20 E: >20

Data:

